

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

2019
RAPORT VJETOR

MISIONI

Të ofrojmë një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh financiare, veçanërisht për popullatën që jeton në zonat rurale të Shqipërisë me qëllim rritjen e përfshirjes financiare dhe zbutjen e varfërisë.

- SHKK lider në zonat rurale
- Pozicionuar fuqishëm në tregun e mikrofinancës
- Konsulentë për anëtarësinë
- Fizikisht afër klientëve
- Shërbime financiare dhe jo-financiare
- Përfshirje e të zgjedhurve
- Norma më të mira interesi

69 MIJË
ANËTARË



63
DEGË



249
STAFI



53%
FEMRA



2500
FSHATRA



4.2
MILIARDË ALL
KREDI



4.3
MILIARDË ALL
DEPOZITA



6 MILIARDË ALL
TOTALI I AKTIVEVE



9.4%
ROE

PËRMBAJTJE

1 Mesazh nga Kryetarja e Këshillit Drejtues	4
2 Qeverisja e SHKK FED invest	5
3 Fuqizimi i Impaktit Social	6
4 Gjithmonë Financë Sociale.....	7
5 Arritja e objektivave për vitin 2019.....	8
6 Rritje e treguesve të aktivitetit dhe financiarë	9
7 Zgjerim i aktivitetit mbështetur në zhvillime teknologjike	10
8 Forcim i partneriteteve financiarë dhe strategjike	11
9 Rritje me projektet strategjike	12
10 Zhvillimi i modelit të biznesit me anëtarin në qendër	14
11 Rritja e biznesit dhe e kapaciteteve nëpërmjet sistemit të ri bankar Flexcube	15
12 Risi dhe zhvillime të teknologjisë.....	16
13 Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të stafit dhe të të zgjedhurve	17
14 Eventet kryesore.....	19
15 Synimet dhe objektivat.....	20
16 Pasqyrat financiare	22
17 Raporti i Auditorit të Jashtëm	23
18 Rrjeti i degëve dhe i kanaleve të FED invest.....	24
19 Rritemi bashkë me anëtarët	26

|| FED invest është promotor i zhvillimit dhe sipërmarrjes jo vetëm në zonën rurale ||

Në kushtet e një zhvillimi të shpejtë të mjedisit ekonomik e teknologjik, FED invest edhe këtë vit shfaqti dinamikën e anëtarëve të tij, duke dëshmuar kapacitetet për t'u paraprirë zhvillimeve e për t'u përshtatur në mënyrë të vazhdueshme.

FED invest është në vite partner i besuar për të gjithë anëtarët e tij:

Ekspertiza solide dhe shumëplanëshe e lejon atë, t'u jetë pranë dhe t'i mbështesë anëtarët, në projektet e tyre të jetës, jo vetëm duke i financuar, por edhe duke i këshilluar, për të realizuar projekte fitimprurëse e afatgjatë.

Përgjegjësia sociale buron nga zemra e modelit të tij të qeverisjes, duke siguruar ofrimin e praktikave më të mira teknologjike dhe një staf të motivuar, kompetent dhe të përgjegjshëm në marrëdhëniet me klientët.

FED invest është promotor i zhvillimit dhe sipërmarrjes jo vetëm në zonën rurale, por thuajse në mbarë territorin e vendit, duke i shërbyer një rrethi të gjerë klientele, nga segmentet më të përjashtuara nga aksesit në financë, deri te SME -të e suksesshme.

Krenar për identitetin e tij të kooperativës financiare, FED invest qeveriset me transparencë, përgjegjësi dhe efikasitet, nëpërmjet funksionimit aktiv të organeve të zgjedhura dhe pavarësisë së nevojshme të manaxhimit, duke bërë të mundur që secili të ushtrojë përgjegjësitë e veta, nëpërmjet dialogut cilësor dhe transparencës së informacionit. Falë kësaj:

Viti 2019 u karakterizua nga një realizim i plotë i objektivave të parashikuara, një zhvillim cilësor i sistemit të qeverisjes korporative dhe i konsolidimit operacional e financiar, manaxhim i kujdesshëm i rrezikut dhe zbatim i normave mbikëqyrëse, një zgjerim dhe forcim i partneriteteve strategjike, përmirësim i nivelit të shërbimeve ndaj anëtarësisë, si dhe një transformim cilësor i sistemit qendror informatik e parkut kompjuterik në të gjithë institucionin.

Aktualisht jemi kooperativa më e madhe financiare në të gjithë vendin, me rreth 70 mijë anëtarë, me një vlerë aktivesh 6 mld. Lekë e me një ofertë gjithëpërfshirëse shërbimesh si në zonën rurale, ashtu dhe atë urbane, në të gjithë territorin e vendit.

Në funksion të strategjisë sonë afatmesme dhe në bashkëpunim me partnerët tanë strategjikë, këte vit ne kemi startuar një sërë projektesh madhore që synojnë rritjen e përfshirjes financiare, ofrimin e shërbimeve jo-financiare dhe sidomos ekspertizën në fushën agri, edukim financiar dhe zgjidhje digjitale, të shpejta e me kosto të ulët për anëtarët tanë.

Besimplotë për një zhvillim të qëndrueshëm e afatgjatë të institucionit, në emër të Këshillit Drejtues, do të doja të shprehja përgëzimet e konsideratën për të gjithë të zgjedhurit, stafin dhe ekipin tonë të manaxhimit, për nivelin e profesionalizmit e përkushtimin e tyre, si dhe partnerët tanë për besimin e mbështetjen e çmuar.



Zana Konini
Kryetare e Këshillit Drejtues
të FED invest

Anëtarësia e FED invest mishëron vlerat tona më të mira të konsoliduara në vite:

Vizion, Bashkëpunim, Ndershmëri,
Profesionalizëm, Përgjegjësi,
Ekspertizë, Fuqizim

Asambleja e Përgjithshme

Në datë 30 prill 2019, zhvilloi punimet Asambleja e Përgjithshme Vjetore e Shoqërisë Kursim Kredi "FED invest", si autoriteti më i lartë vendimmarrës dhe demokratik, ku të gjithë anëtarët kanë të drejtën e votës, sipas parimit një anëtar-një votë.

Në Asamble morën pjesë delegatë, përfaqësues nga të gjitha degët në vend, si dhe të ftuar nga institucione partnere kombëtare dhe ndërkombëtare, ku mund të veçojmë përfaqësuesit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe JICA.

Këshilli Drejtues i FED invest në zbatim të strategjisë së miratuar nga Asambleja e Përgjithshme siguron garantimin e interesave të anëtarësisë, arritjen e objektivave strategjike dhe një kontroll të manaxhimit të kujdesshëm të rrezikut.

Zj. Zana Konini, Kryetare,
eksperte në Financë Sociale prej 28 vjetësh;
Zj. Merita Cani, eksperte në Financë dhe Bankë,
Doktor i Shkencave;
Zj. Delina Ibrahimaj, eksperte në Financë dhe Bankë,
Doktor i Shkencave;
Z. Valentin Gocaj, ekspert në fushën e Bujqësisë;
Z. Drini Salko, ekspert në Financë dhe Bankë, Prof. Dr.;

Komiteti i Kontrollit

Zj. Haxhire Demirxhiu, Kryetare,
eksperte në fushën e kontabilitetit dhe auditimit;
Zj. Lefteri Liçka, eksperte në fushën e kontabilitetit;
Z. Flamur Rroshi, ekspert në fushën e Bujqësisë;



3 FUQIZIMI I IMPAKTIT SOCIAL

FED invest, me anëtarët në zemër të çdo aktiviteti, do të vazhdojë të ofrojë shërbim të nivelit të lartë, duke synuar rritjen e vazhdueshme të besnikërisë dhe kënaqësisë së anëtarësisë.

STRATEGJIA



KULTURA



STRUKTURA



FED invest ka qëndruar pranë anëtarëve dhe në ditë të vështira, në rastet e fatkeqësive natyrore, si përmbytje, ngrica, etj. Së fundi, FED invest kontribuoi me ndihma direkte për punonjësit e prekur nga tërmeti, lehtësoi shlyerjen e detyrimeve të anëtarëve të dëmtuar dhe ndihmoi në përballimin e pasojave të tërmetit të nëntorit 2019.

FED invest u ka ardhur gjithnjë në ndihmë edhe grupeve vulnerabël, të marginalizuara të shoqërisë, emigrantëve, popullsisë së përjashtuar nga përfshirja financiare në zonat e thella rurale.

FED invest do të vazhdojë të mbetet partner i rëndësishëm financiar edhe i gjeneratës së dytë të familjeve shqiptare, anëtare të tij.



DIMENSIONI HUMAN

Akses në financë edhe për individët e pashërbyer nga sektori bankar;

Edukim financiar. Ndikim në rritjen e punësimit, uljen e emigracionit, rritjen e të ardhurave;

Shërbime jo-financiare, shërbime këshillimore të biznesit dhe ekspertizë agri.



DIMENSIONI GJEOGRAFIK

Prioritet në zonat e thella dhe rurale (80% e anëtarëve janë në zonën rurale);

Mbulim në bashkitë më të mëdha;

Akses tek përfituesit e shërbimeve në mënyrë proaktive dhe me kanale online.



DIMENSIONI GJINOR

Mbështetje dhe fuqizim i grave sipërmarrëse, 24% e anëtarëve janë femra;

Pjesëmarrje e grave në shërbimet financiare dhe vendimmarrje.

2016

► Shkurt

Themelimi i SHKK-së së re FED invest.

► Mars

Licencimi nga Banka e Shqipërisë i SHKK FED invest.

► Prill

Miratimi i Planit Strategjik nga Asambleja e Përgjithshme.

► Korrik

Nënshkrimi i "Fondit të Garancisë" për kreditë rurale me RCGF.

► Nëntor

Fillimi i projektit PPP me Qeverinë Holandeze, EFSE DF, RIAS dhe FED invest.

2017

► Janar

Përfshirja në skemën e sigurimit të depozitave.

► Prill

Vlerësimi nga Banka Botërore si një histori suksesi në "Raportin e Zhvillimit të Financave Globale".

► Qershor

Nënshkrimi i marrëveshjes me JICA-n dhe Qeverinë Shqiptare të projektit 4-vjeçar për përfshirjen financiare.

► Dhjetor

Nënshkrimi i programit Italo-Shqiptar për zhvillimin e SME-ve.

► Gjatë vitit

-Plotësimi i kuadrit të plotë rregullativ për menaxhimin e riskut në FED invest.

- Hartimi i strategjisë, manaxhimit të sigurisë dhe sigurimi i burimeve financiare dhe TIK.

2018

► Janar

- Çmimi "Bleta e Artë", për gruan në biznes.
- Zbatimi i programit të instrumentit të garancisë me EaSi-n.

► Shkurt

Fillimi i projektit 4-vjeçar me JICA dhe Qeveria Shqiptare: "Përfshirja financiare e fermave familjare në Shqipëri".

► Qershor

Laçimi i fazës së dytë të Projektit me Qeverinë Holandeze, EFSE DF, RIAS dhe FED invest në Ministrinë e Jashtme në Hagë.

► Dhjetor

-Firmosja e kontratës për sistemin e ri - Oracle Flexcube 12.4 dhe infrastrukturës së IT.
-Miratimi i një linje financimi nga EFSE.

► Gjatë vitit

Sigurimi i burimeve financiare, asistencës teknike për IT dhe procesi i prokurimit të CBS.

2019

► Mars

Hapja e 3 Degëve të reja në Kukës, Laç dhe Bilisht.

► Prill

Ceremonia Zyrtare e Dorëzimit të CBS të ri dhe infrastrukturës kompjuterike për të gjithë rrjetin.

► Shtator

Fillimi i ndërtimit të Qendrës ABA (Agro Biznes Asistencë) dhe platformës abonline.al Aplikimi në Bankën e Shqipërisë për marrjen e Licencës së pagesave.

► Tetor

Marrja e çmimit të Kodit të Mirëqeverisjes nga Komisioni European.

► Nëntor

Lidhja e kontratës së parë për borxhin e varur me Helenos Fund dhe World Planet Foundation.

► Gjatë vitit

Implementimi i CBS.

RRITJA E AKTIVITETIT

- Rritja e numrit të anëtarëve me 13.1% (nga 61,061 në 69,073) dhe hapja e 3 degëve të reja;
- Rritja e portofolit të kredisë me 12.1%;
- Rritja e portofolit të depozitave me 13.%;

CILËSIA E PORTOFOLIT TË KREDISË DHE FUQIZIMI I KAPITALIT

- PAR 90 ulur me 0.4% (nga 5.8% në 5.4%);
- Rezultati neto prej 39.7 milionë Lekë përfaqëson 9.4% kthim mbi kapitalin;
- Kapitali është rritur me 10.8% (nga 401.9 milionë Lekë në 445.4 milionë Lekë);

RRITJA E KAPACITETEVE

- Implementimi i sistemit të ri FlexCube deri në fazën përfundimtare të daljes Live;
- Rinovim i plotë i qendrës të serverave dhe infrastrukturës kompjuterike në qendër e degë;
- Rritur numri i stafit me 8.3% (nga 230 në 249);

DIVERSIFIKIM I FONDEVE PËRMES PARTNERITETEVE STRATEGJIKE


- Lidhja e kontratës për borxhin e varur prej 0.5 milionë Euro me Helenos Fund;
- Lidhja e kontratës së kredisë pa interes prej 0.3 milionë Euro me World Planet Foundation;
- Shtimi i garancisë nga Fondi i Garancisë së Kredisë Rurale me 3.2 milionë Euro;

MË SHUMË SHËRBIME FINANCIARE DHE JO-FINANCIARE


- Rritja e financimit të segmentit SME me 2.5 herë;
- Fillimi i ndërtimit të Qendrës ABA dhe i platformës abaonline.al;
- Dorëzimi i dokumentacionit dhe aplikimit tek Banka e Shqipërisë për licencimin e pagesave;

6 RRRITJE E QËNDRUESHME E TREGUESVE TË AKTIVITETIT DHE ATYRE FINANCIARE


Ecuria e portofolit të kredive dhe depozitave dhe numri i anëtarëve 2017 - 2019




Ecuria e Kapitalit dhe Kthimi mbi Kapitalin 2017 - 2019



Ecuria e zërave kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve 2017 - 2019




Ecuria e Portofolit me Probleme dhe Rezerva për Humbjet e Kredive



ZGJERIM I AKTIVITETIT MBËSHTETUR NË ZHVILLIME TEKNOLOGJIKE FUQIZIM I RËNDËSISHËM I KAPACITETEVE NJERËZORE DHE INFRASTRUKTURËS

Shpërndarja e portofolit të kredive sipas sektorëve,
31 dhjetor 2019




Portofoli i kredisë

Në fund të vitit 2019 portofoli i kredisë është 4.2 miliardë lekë për 13,692 kredimarrës aktivë. Gjatë vitit teprica e kredisë është rritur me 12.1%. Volumi i disbursuar i kredive prej 2.3 miliardë Lekë i korrespondon 5,974 kredive të disbursuara, me vlerë mesatare të disbursuar për kredi 380 mijë Lekë. Volumi i disbursimeve është rritur me 7.2% krahasuar me vitin 2018.

Peshën kryesore në portofolin e kredive e zënë kreditë për sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë, të cilat kanë patur kontributin kryesor në rritjen e portofolit për vitin 2019. Kredidhënia në sektorin e agrobiznesit është rritur me 19.5% kundrejt vitit 2018.



% e volumit të depozitave sipas produktit
më 31 Dhjetor 2019



Cilësia e Portofolit të Kredisë

Ruajtja e cilësisë së portofolit të kredisë brenda parametrave është një objektivi kryesor, që garanton qëndrueshmëri dhe konsolidim të Institucionit në vijimësi. Në fund të dhjetorit 2019, cilësia e portofolit të kredive shënoi përmirësim prej 0.4%, nga 5.8% në 5.4%, krahasuar me fundin e vitit 2018.

Portofoli i depozitave

Në fund të dhjetor 2019 portofoli i depozitave është 4,3 miliardë lekë tek 2,943 depozitues aktivë. Gjatë vitit 2019 portofoli i depozitave është rritur me 480.5 milionë Lekë ose 13%. Volumi dhe numri i depozituesve të rinj ka shënuar rritje në raport me 2018.

PARTNERËT TANË EKZISTUES DHE TË RINJ JANË NJË ASET I ÇMUAR PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT NËPËRMJET FINANCIMEVE, NJOHURIVE TEKNIKE, RRJETIT TË KONTAKTEVE.

Ne vazhdojmë të rritemi e forcohemi nëpërmjet bashkëpunimit me partnerë strategjikë ndërkombëtare, duke:

- Përfitur asistencë e këshilla të çmuara teknike për të ndërtuar strategji e modele biznesi;
- Siguruar financime e grante për fuqizimin e kapitalit dhe zgjerimin e veprimtarisë;
- Inicuar dhe eksperimentuar me risi teknologjike dhe digjitale;
- Zhvilluar kapacitete për të manaxhuar më mirë riskun dhe fuqizuar punonjësit e manaxhimin;
- Përmirësuar qeverisjen korporative dhe kuadrin rregullator;

Interreg 
Balkan-Mediterranean
Skills4MSEs

EFSE
EUROPEAN FUND FOR SOUTHEAST EUROPE


Rabobank



Ministry of Foreign Affairs of the
Netherlands

jica

 **AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO**




EUROPEAN
INVESTMENT
FUND


**RURAL
CREDIT GUARANTEE FOUNDATION**


REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

HELENOS

**WHOLE
PLANET
FOUNDATION**


REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË

ZHVILLIMI I SHËRBIMEVE FINANCIARE NË ZONAT RURALE

Faza II e Projektit me Qeverinë Holandeze, EFSE DF dhe Rabo Partnership



Ministry of Foreign Affairs of the Netherlands



STRATEGJIA E MARKËS FED INVEST NË GJITHË RAJONET E VENDIT, AKTIVIZIMI I SHITJEVE, STRATEGJIA E KANALEVE TË SHUMËFISHTË.



ASISTENCË NË TË GJITHA FAZAT E IMPLEMENTIMIT TË SISTEMIT TË RI FLEXCUBE, RINOVIMIN E QENDRËS SË TË DHËNAVE, SIGURISË SË IT-SË, ETJ.



POZICIONIMI I FED INVEST NË BOTËN DIGJITALE TË SHËRBIMEVE FINANCIARE. NDËRTIMI I STRATEGJIVE PËR ZHVILLIMIN E TESTIMIN E RISIVE TË TEKNOLOGJISË DHE FINTECH PËR PËRSHPEJTIMIN E MUNDËSIVE TË BIZNESIT.



ZHVILLIMI DHE KOMUNIKIMI NËPËRMJET KANALEVE DIGJITALE. OPTIMIZIMI I KANALEVE TË REJA TË MARKETINGUT DIGJITAL.



NDIHMË PËR HARTIMIN E BIZNES PLANIT STRATEGJIK 3 VJEÇAR DHE SKENARËT E FORCIMIT TË KAPITALIZIMIT TË FED INVEST.



PËRPUNIMI I KONCEPTIT TË FINANCIMIT TË ZINXHIRIT VLERËS DHE PRODUKTEVE.



QËLLIMI I PROJEKTIT FIAS - PROJEKTI I PËRFSHIRJES FINANCIARE TË FERMAVE FAMILJARE



PËRFSHIRJA
FINANCIARE
E FAMILJEVE
TË VOGLA SHQIPTARE

FIAS

- FED INVEST OFRON PRODUKTE FINANCIARE DHE SHËRBIME JO-FINANCIARE, QË PLOTËSOJNË NEVOJAT E ANËTARËVE NË MËNYRË TË QËNDRUESHME.
- KONSUMATORËT RRSIN AFTËSINË E TYRE FINANCIARE.




REZULTATET	PËRDORIMI I PRODUKTEVE FINANCIARE TË ZHVILLUARA PËRMES PROCESIVE TË "ANËTARI NË QENDËR"	KRIJIMI DHE FUNKSIONIMI I QENDRËS SË NJOHURIVE AGRI, DUKE OFRUAR SHËRBIME JO-FINANCIARE	ZGJERIMI I AKSESIT NË SHËRBIME FINANCIARE DHE JO-FINANCIARE PËRMES ZHVILLIMEVE TË TEKNOLOGJISË
-------------------	---	---	--



AKTIVITETET E PROJEKTIT	4. FORCIMI E ZBATIMI I FILOZOFISË SË ZHVILLIMIT TË PRODUKTEVE FINANCIARE ME FOKUS TEK ANËTARI	5. ZHVILLIMI I KAPACITETEVE PËR SHËRBIME JO-FINANCIARE	6. ZGJERIMI I AKSESIT DIGJITAL NË SHËRBIME FINANCIARE E JO-FINANCIARE
	3. IMPLEMENTIMI I SISTEMIT TË RI INFORMATIK, PËRFSHIRË MIS DHE CRM		
	2. STUDIMI I VLERËSIMIT TË NEVOJAVE TË ANËTARËVE		
	1. PROKURIMI I PROGRAMEVE KOMPJUTERIKE & HARDWARE		



AKTIVITETE TË PROJEKTIT FIAS NË ZBATIM TË PARIMIT “ANËTARI NË QENDËR”



Mars 2019 përfundoi studimi i Vlerësimit të nevojave, realizuar nga projekti “FIAS”, me mbi 1000 familje në të gjithë vendin.

Testimi dhe mbledhja e reagimeve të anëtarëve me grupe fokusi për dy produkte të reja, bazuar në nevojat e anëtarëve.

Konceptimi i Qendrës ABA dhe llojeve të shërbimeve jo-financiare, mbi bazën e nevojave të fermerëve.

Hartimi i planit për edukimin dhe përfshirjen financiare të anëtarëve.

Testimi i moduleve të edukimit financiar me anëtarët dhe punonjësit në terren.

RRITJA E BIZNESIT DHE E KAPACITETEVE NËPËRMJET SISTEMIT TË RI BANKAR FLEXCUBE

- Transformim rrënjësor i arkitekturës, infrastrukturës dhe qeverisjes së TIK;
- Rinovim i plotë i qendrës së të dhënave me standardet e duhura teknike dhe të sigurisë;
- Konfigurimi i sistemit të ri, parametrizimet e Librit të ri të llogarive, produkteve ekzistuese mbi bazën e studimit të kërkesave të biznesit;
- Krijimi i ambienteve test dhe i infrastrukturës mbështetëse (software dhe hardware);
- Trajnimi intensiv i punonjësve në degë dhe zyrën qendrore;
- Realizimi me sukses i proceseve të migrimit dhe kuadrimi i të dhënave;
- Ekzekutimi i të gjitha fazave dhe skenarëve të testimit nga përdoruesit;
- Procese të reja dhe procedura të reja operacionale (Procedurat e Arkës, Kredisë, Depozitave dhe Anëtarësimit);
- Instalimi i linjave të dedikuara të internetit në të gjitha zyrat;
- Përfundimi me sukses i provës gjenerale.



**Një projekt madhor,
i realizuar në
kohë rekord falë
dedikimit dhe
profesionalizimit të
stafit të FED invest,
financimit të JICA-s,
partneritetit me
Facilization dhe
asistencës teknike të
Rabobank.**



RISI DHE ZHVILLIME TË TEKNOLOGJISË

Përgjatë 2019 janë ndërmarrë këto nisma:

1. Implementimi i sistemit të ri informatik



- Me ndihmën e JICA-s u financua blerja e licencave të sistemit FlexCube, serverave, infrastrukturës së rrjetit dhe gjithë parku i kompjuterave (210) dhe printerave (40) për stafin e FED invest;
- Përgatitja e Planit të Biznesit, dokumentacionit dhe aplikimi për licencën e pagesave dhe transfertave pranë Bankës së Shqipërisë (shtator 2019);
- Implementimi i sistemit të ri filloi në janar 2019 dhe u përmbyll me sukses brenda harkut kohor të një viti.



Momente nga ceremonia e dorëzimit të sistemit të ri të IT-së nga JICA, në prani të Ambasadorit të Japonisë, Shkëlqesisë së tij, Z. Makoto ITO dhe Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, Shkëlqesisë së saj, Znj. Anila DENAJ. 24 prill 2019



2. Ngritja e Qendrës ABA

FED invest, në bashkëpunim me Projektin FIAS ideuan konceptin e ofrimit të shërbimeve jo-financiare për fermerët shqiptarë përmes Qendrës ABA (Asistenca për Agro-Biznes). Këto shërbime do të ofrohen përmes aktiviteteve direkte në zyrat e qendrës ABA në Lushnjë dhe platformës digjitale, www.abaonline.al.

Qendra me dy kanalet e saj do të ndihmojë fermerët të rriten nëpërmjet:

- Njohurive të teknologjisë në bujqësi e blegtori;
- Trajnimeve dhe edukimit financiar për zhvillimin e kapaciteteve;
- Mundësive të bashkëveprimit mes aktorëve të zinxhirit të vlerave;
- Lehtësimit të aksesit në treg me qëllim zhvillimin e biznesit.



Në tremujorin e IV-ërt të vitit 2019, u realizuan zhvillimet e Fazës së Parë të platformës abaonline.al me Kompaninë Pragmatic.

- Filluan punimet për ngritjen e Qendrës ABA.
- U pasurua përmbajtja e platformës.

3 ZHVILLIMI I KAPACITETEVE PROFESIONALE TË STAFIT DHE TË TË ZGJEDHURVE

FED invest vijon të rrisë aftësitë profesionale e teknike të punonjësve dhe të të zgjedhurve. Gjatë vitit 2019, çdo punonjës i FED invest është trajnuar mbi 4 ditë në fushat e marketingut, zinxhirit të vlerës, markës, operacionet, qasjes së anëtarit në qendër etj.

Trajnime mbi shitjen dhe Zinxhirin e Vlerës me JICA



Vizita në Japoni

Udhëtim studimor në Japoni nga stafi, manaxhimi e anëtarë të Këshillit Drejtues të FED invest, Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, Bankës së Shqipërisë në lidhje me rolin e institucioneve shtetërore, kooperativave financiare dhe aktorëve të tjerë në mbështetjen e zhvillimit rural.



Trajnim pranë Rabobank, Programi i Partneritetit



Seminare mbi markën



Seminare rajonale me të zgjedhur dhe staf mbi vlerat e markës së FED invest.

PUNONJËSIT TANË

KRENARË QË PUNOJNË NË FED INVEST!

SKUADRA E FED INVEST RREDIT, ZHVILLOHET PROFESIONALISHT DHE KONSOLIDOHET NË VITE.
MOTIVIMI YNË BURON NGA BESIMI E BESNIKËRIA E ANËTARËSISË SONË.

"Marrëdhënie
e ngushtë
me komunitetin"

"Kur fillon punën
në FED invest nuk
je vetëm"

"Procedura të shpejta
e transparente kredie"

Jemi krenarë për
përfaqësimin dinjitoz të grave
në të gjitha nivelet e drejtimit
dhe vendimmarrjes:

53% e stafit
Afro 39% në pozicione
drejtuese;
24% e anëtarësisë



"Punojmë në
ekip"

"Ndihmojmë anëtarin në
zgjidhjen e problemeve"

"Rritemi
bashkë me
anëtarët"

"Korrektesi dhe
profesionalizëm"

"Kooperativë
e madhe
financiare"

4. EVENTE KRYESORE 2019

24 prill 2019, Ceremonia e dorëzimit të Sistemit të Teknologjisë nga JICA.



24 prill 2019, Mbledhja e JCC (Komitetit Koordinues të Projektit).



8 maj 2019, Vizitë e Ambasadores së Holandës dhe Projektit të Rabobank në Lushnje në zyrat e FED.



22 maj 2019, Universiteti Bujqësor, Leksion i hapur mbi financën sociale.



maj 2019, Vizitë studimore në institucione financiare e Bankën Qendrore të Maqedonisë së Veriut.



22 shtator 2019, Mbledhja e JCC, Faza II e Projektit FiAS



Pjesëmarrje e ekipit të JICA nga Tokio dhe Zyra e Ballkanit, Znj. Haruko KAMEI, Z. Kazuto TSUJI dhe Z. Hideya KOBAYASHI në mbledhjen e JCC

shtator 2019, Pjesëmarrje e Z. Perlat Sulaj në panelin e Konferencës së ESFE-s, Beograd.



shtator 2019, Dita Europiane e Mikrofinancës, aktivitet i SHIM, Tiranë.



tetor 2019, Komisioni European Marrja e çmimit për Kodin European të Sjelljes së Mirë për mikrokredinë.





|| FED INVEST SYNON TË SHNDËRROJË ORGANIZIMIN E TIJ DREJT NJË INSTITUCIONI QË OFRON TË GJITHA SHËRBIMET BANKARE, FINANCIARE DHE JO FINANCIARE. ||

FED invest synon të shndërrojë organizimin e tij drejt një institucioni që ofron të gjitha shërbimet bankare, financiare dhe jo financiare. Kjo pasi FED invest ka ambicien që të jetë një aktor i rëndësishëm në rritjen e ekonomisë në Shqipëri. Ne kemi qëllime të qarta për vitet e ardhshme në ofrimin e shërbimeve ndaj anëtarësisë, ku synimet dhe objektivat tona strategjike janë:

- Të rrisim rrjetin e anëtarëve nëpërmjet shtimit të prezencës dhe penetrimit në zonat rurale dhe urbane me produkte konkurruese të kredive dhe depozitave;
- T'u ofrojmë anëtarëve tanë shërbime të reja financiare të tilla si llogari rrjedhëse, pagesa dhe transfertat, overdratë biznesi dhe personale, paketa kreditimi të zinxhirit të vlerës;
- T'u ofrojmë anëtarëve tanë shërbime financiare të digjitalizuara bashkëkohore;
- Të mundësojmë akses për shërbime jo financiare direkte dhe të digjitalizuara për të gjithë fermerët e vegjël dhe të mesëm dhe aktorët e tjerë të zinxhirit ushqimor në Shqipëri;
- Të forcojmë kapitalin dhe të kemi një rritje të qëndrueshmërisë financiare që forcohet nga viti në vit, duke fuqizuar kapacitetet e manaxhimit të riskut;
- Të rrisim kënaqësinë e anëtarëve për shërbimet e marra nëpërmjet ofrimit të shërbimeve ekselente.

Për arritjen e këtyre synimeve dhe objektivave do të vazhdojmë të investojmë në rritjen e kapaciteve të stafit dhe motivimit të punonjësve, përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve për ofrimin e shërbimeve, forcimin e partneriteteve strategjike vendase dhe të huaja dhe në konsolidimin e një infrastrukture moderne.

FED invest do të kapitalizojë më tej pozicionimin e vet strategjik në treg, duke ofruar produkte me çmime konkurruese dhe pranë anëtarëve në zonat ku ata jetojnë. Krahas futjes së shërbimeve të digjitalizuara, ne do të vazhdojmë të zgjerojmë rrjetin e degëve dhe të kujdesemi për kontaktin personal dhe dimensionin human të marrëdhënieve me anëtarët tanë dhe komunitetet ku ata jetojnë.

ANËTARË



DHJETOR 2019

69 MIJË

DHJETOR 2023

100 MIJË

DEGË



DHJETOR 2019

63

DHJETOR 2023

70



PORTOFOLI I KREDISË

DHJETOR 2019

4.2 MILIARDE LEKË

DHJETOR 2023

6.9 MILIARDË LEKË

Shërbime Jo-financiare

Të krijojë dhe zhvillojë një qendër bujqësore që siguron shërbime jo-financiare për anëtarët e saj, përfshirë edukimin financiar, trajnime, lidhje midis aktorëve në zinxhirin e vlerës.

Rritje e qëndrueshmërisë financiare

Të sigurojë një mjaftueshmëri të kapitalit mbi 13% përgjatë gjithë kohës si rrjedhojë e rritjes së rezultatit neto dhe injektimit të borxhit të varur.

Gamë e gjerë shërbimesh/produktesh financiare

Të ofrojë shërbimin e pagesave, llogarive rrjedhëse dhe overdrafteve gjatë vitit 2020, transfertat deri në vitin 2021.

Edukimi Financiar

Të zhvillojë programe dhe fushata të dedikuara për edukimin financiar të anëtarësisë.



PORTOFOLI I DEPOZITAVE

DHJETOR 2019

4.3 MILIARDE LEKË

DHJETOR 2023

7 MILIARDË LEKË

Lider në zonat rurale për fermerët

Të krijojë dhe zhvillojë një qendër bujqësore që siguron shërbime jo-financiare për anëtarët e saj, përfshirë edukimin financiar, trajnime, lidhje midis aktorëve në zinxhirin e vlerës.

Fuqizim i partneriteteve strategjike

Të sigurojë ndihmë teknike të specializuar për zhvillimin dhe mbështetjen institucionale.

Rritje e ndikimit social

Të vendosë partneritet strategjik me sektorin qeveritar për skemat e promovimit, duke ndikuar në krijimin e vendeve të reja të punës.

Kënaqësia e Punonjësve

Të ruajë talentin brenda Institucionit, duke ofruar mundësi trajnime të mëtejshme e përmirësim të aftësive profesionale. Të sigurojë një paketë të përshtatshme shpërblimi dhe mirëqenieje sociale.

Më 31 Dhjetor 2019

(në mijë lekë, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Aktivitet	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Mjete monetare	337,193	290,280
Depozita me afat	877,519	1,014,452
Letra me vlerë	110,439	112,208
Interesa Pjesëmarrës	718	718
Kredi	3,980,476	3,555,988
Aktivitet afatgjata materiale	492,097	132,630
Aktivitet afatgjata jomateriale	75,578	7,659
Aktive të tjera	119,686	37,806
Totali i aktiveve	5,993,706	5,151,741
Detyrimet		
Hua	967,051	847,251
Detyrime të qirasë	4,937	-
Fond për rezervë statistikore	83,967	75,670
Depozita të anëtarëve	4,269,585	3,777,176
Detyrime të tjera	60,407	49,706
Grante të shtyra	101,441	-
Borxh i varur	60,885	-
Totali i detyrimeve	5,548,273	4,749,803
Kapitali		
Kapitali	145,732	141,996
Rezervat	259,942	229,507
Teprica e mbartur	39,759	30,435
Total i kapitalit	445,433	401,938
Total i kapitalit dhe detyrimeve	5,993,706	5,151,741

Më 31 Dhjetor 2019

(në mijë lekë, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të ardhurat nga interesat	555,636	509,109
Shpenzime për interesa	(86,444)	(88,835)
Të ardhura neto nga interesi	469,192	420,274
Shpenzime nga zhvlerësimi i huave, neto	(44,253)	(68,765)
Të ardhura neto pas zhvlerësimit të huave	(44,253)	(68,765)
Të ardhura nga komisionet,neto	68,623	56,562
Të ardhura neto nga komisionet	68,623	56,562
Të ardhura nga investimet	15,074	38,787
Të ardhura nga shitja e portofolit të kredive të fshira	26,479	-
Shpenzime interesi për huatë	(25,635)	(23,761)
Të ardhura jo-operative neto	6,359	6,984
Të ardhura të tjera neto	22,277	22,010
Shpenzime personeli	(281,942)	(244,012)
Shpenzime administrative	(160,455)	(136,623)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(24,906)	(10,987)
Shpenzime për ASD	(8,777)	(8,024)
Totali i shpenzimeve	(476,080)	(399,646)
Teprica e periudhës	39,759	30,435



Grant Thornton Sh.p.k.
Rr. Sami Frashëri, Korçë 2016 T.A.
Sh. B. Shekulli, 10 100
Tirana, Shqipëri
T +36 4 22 74 100
F +36 4 22 18 180
www.grantthornton.it

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Këmbimin Drejtues të FED Invest

Opinion

Ne kemi auditur pasqyrat financiare të Shoqërisë së Kurrimit Kreditiv FED Invest ("Oganizata"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën të shërbimeve dhe shërbimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parant për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shërbimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël me të shprehura.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Oganizatës janë të përgjithshme, në të gjitha aspektet materiale, të përputhshme me ligjin shqiptar "Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe ligjin nr. 32 datë 19 maj 2016 "Për Shoqëritë e Kurrimit Kreditiv dhe Unioneve e tyre".

Reja për Opinimin

Ne e kryem auditimin tonë të përputhshme me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-it). Përgjithësisht, tosa sipas këtyre standardeve janë përkrahur në mënyrë të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjithësi e Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Oganizata në përputhje me Kodin e Etikës të Komitativit Profesional të shtetit nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilitetin (IESBA), kërkuesit e të cilave janë të zbatueshme për auditarin e pasqyrave financiare të Shoqërisë, si dhe kemi përbërur përgjithësisht të qendrueshme dhe të përkrahshme për të dhënat që bazohen në opinionin tonë.

Përgjithësi e Detyrimit dhe të Përkrahshme të Ngjarjeve të Qendrueshme të Pasqyrave Financiare

Drejtuesit janë të përgjithshme për përgjithësinë dhe përputhshmërinë e drejtës të pasqyrave financiare të përputhshme me me ligjin shqiptar "Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe ligjin nr. 32 datë 19 maj 2016 "Për Shoqëritë e Kurrimit Kreditiv dhe Unioneve e tyre", dhe për ato kontrole të brendshme që drejtuesit i gjykojnë të nevojshme për të bërë të mundur përgjithësinë e pasqyrave financiare që nuk përmbledhojnë asnjë material, qoftë për shkak të madhësisë apo gabimit.

Në përgjithësinë të pasqyrave financiare, drejtuesit janë të përgjithshme për të vlerësuar shtimin e Shoqërisë për të vlerësuar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çdo gjë që kanë të bëjë me vijimësinë dhe duke përdorur pamund kontabël të vijimësisë përveç se në variet kur drejtuesit synon të kuptojnë shtimin ose të ndryshojnë shtimin, ose nëse nuk ka alternativë qendrueshme përveç se në vijimësi.

Ato që janë të sigurtas me qeveritjen janë të përgjithshme për shprehjet e procesit të raportimit financiar të vlerësimit.

Përgjithësi e Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivi i tosa është që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të tërta nuk kanë anomalitë materiale, për shkak të madhësisë apo gabimit, dhe të shprehim një raport auditimor që përshfaq opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomalitë materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijojnë si rezultat i gabimit ose i madhësisë dhe korreduresh materiale nëse, individualisht ose të marrë së bashku, përveç se të arrijmë të arsyeshme të informacionit vlerësuesit ekonomike të përdoruesve, të marrë bazuar në këto pasqyrat financiare.

Si përsë e një auditimi të përputhshme me SNA-it, të ushtrime gjykimin dhe shprehjet profesionale gjatë procesit të auditimit. Në gjykimet:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomaliave materiale të pasqyrave financiare, për shkak të gabimeve ose madhësisë, projektimit dhe zbatimit të procedurave auditimorë të cilat e përgjithësinë këtyre rrezikëve, si dhe marrim evidencë auditimorë të gjera dhe të mirënjohura për të krijuar besim e opinionin tonë. Rezultati i mësimit të një gabimi material që vijon si rezultat i një madhësisë, është me të lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi madhësinë mund të përfshijë marrëveshje të falsifikimit, falsifikimit, korruptivitetit të qëllimshëm, keqkuptimit, ose detyrë të kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrolleve të brendshme të lidhura me auditimin, për të planifikuar procedurat të përkrahshme në variet të zbatimit, dhe jo për të shprehur një opinionin nëse efektshmëria e kontrolleve të brendshme të zbatimit.
- Vlerësojmë kualitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shprehjes të bëra nga drejtuesit.

bazuar në evidencat e tosa gjatë auditimit, kontabëlton nëse ekziston një pasqyrë materiale e lidhur me ngjarjet ose kushte të cilat mund të shprehin dyshime në afërsinë e entitetit për të vlerësuar në vijimësi. Nëse kontabëlton që ekziston një pasqyrë materiale, ne duhet të arrijmë vlerësimin në raportin tonë të auditimit për informacionet shprehjes përkrahshme të pasqyrave financiare ose, nëse këto informacione shprehjes janë të pamirënjohura, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimi i tosa janë të bazuar në evidencat e auditimit të marrë dhe në dritën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushte të arsyeshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë të vazhdojë në vijimësi.

- Vlerësojmë përcaktimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përshfaqjen e informacioneve shprehjes, dhe nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transparenca dhe ngjarjet bazë në vijimësi të shtetë që të arrijmë një përcaktim të drejtë.

Ne komentonim me ata të cilët janë të sigurtas me qeveritjen, midis çështjeve të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjërat e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontabël dhe brendshme të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
12 maj 2020



TIRANË

UNAZA E RE
PAZARI I RI
PETRELË
BARZEZË
KASHAR
VORË
KAMËZ
MARIKAJ
ZALLHERR
SAUK
TIRANA E RE
21 Dhjetori
RRETHI TIRANA
RURALE

POGRADEC

POGRADEC
ÇERRAVE

KORÇË

LIBRAZH

LIBRAZH
PËRRENJAS

GRAMSH

ELBASAN

ELBASAN
MOLLAS
GJINAR
BELSH
ÇËRRIK
KUQAN

PEQIN

VLORË

VLORË
RRUGA E RE
HIMARË
SKELË
ORIKUM
NOVOSELË

SARANDË

FIER

VAJKAN
LEVAN
FIER
SVA
FIER 2
DAULLAS

LUSHNJE

KËMISHTAJ
LUSHNJE
REMAS
KRUTJE
ÇERMË
DIVJAKË
BUBULLIMË
RRETHI LUSHNJE

SHKODËR

SHKODËR
BUSHAT

KOPLIK

LEZHË

PËRMET

DURRËS

DURRËS
SHIJAK
MANËZ

BERAT

BERAT
URA VAJGURORE
KUÇOVË

KAVAJË

GJIROKASTËR

KUKËS

LAÇ

BILISHT



KANALE TË REJA KOMUNIKIMI ONLINE

Sot jemi më afër anëtarëve tanë, pa kufizim vendndodhjeje gjeografike. Tashmë, më pranë anëtarëve me kanale të reja digjitale.



- Mësoni më shumë rreth nesh e produkteve tona përmes faqes sonë të re të internetit, www.fedinvest.al.
- Aplikoni për kredi online direkt nga faqja jonë e internetit
- Ndani me ne përvojat tuaja në rrjetet sociale: Facebook, LinkedIn.
- Llogarisni këstin e kredisë dhe interesin e depozitës.



E-BANKING

SË SHPEJTI, vijmë me shërbime bankare online nëpërmjet aparatit tuaj celular dhe kompjuterit.



Apliko online

- Emri & Mbiemri**
Shëruaj emrin
Shëruaj mbiemrin
- Adresa & Numri i telefonit**
Shëruaj adresën
Shëruaj numrin e telefonit
Zgjidh shtet
- Shuma & Qelimi i kredisë**
Shëruaj shumën e kredisë
Shëruaj qëllimin e kredisë

DERGO **ANULLO**

SË SHPEJTI, fermerët do të kenë qendrën e tyre fizike dhe virtuale **ABA të asistencës agri**. Na vizitoni në platformën tonë të re www.abaonline.al.



ILIR BOROÇI

Gjatë gjithë kohës, në situata të vështira apo të mira, FED invest na ka mbështetur që kur babai im u bë anëtar në vitin 2006.

Në veçanti, mbaj mend kur familja e kishte të vështirë të paguante këstet e kredive për shkak të luhatjeve të çmimeve të tregut që ne nuk mund t'i kontrollonim. FED invest bashkëpunoi ngushtë me babanë tim dhe arriti të sigurojë ekspertizën teknike dhe ripagimin e huasë. Për pak kohë, familja ime ishte në gjendje të shlyente kredinë. Ne madje morëm një kredi tjetër për të ri-investuar në fermën tonë, e cila u pagua e plotë dhe në kohë.

Duke parë marrëdhëniet e mira dhe bashkëpunuese që prindërit e mi kishin me FED invest ndër vite, u nxitam që të bëhem anëtar në vitin 2019 dhe ta vazhdojmë këtë partneritet të suksesshëm në gjeneratën e ardhshme. Marrëdhënia e ngushtë me FED invest na ka mundësuar që të modernizojmë biznesin tonë dhe të zgjerojmë tregtinë tonë në vendet e tjera.

Tani zotëroj një serrë moderne me kastravec, kam një kontratë bashkëpunimi me një kompani të madhe austriake dhe punësoj dhjetë punëtorë sezonalë. Unë e di se mund t'i besoj të ardhmen financiare të familjes time FED invest, sepse ata kanë bërë një investim afatgjatë tek ne dhe na kanë ndihmuar me ekspertizën e duhur në kohë të vështira.



KUDRET DOGA

Për mua është e vështirë të përfytyrosh sesi kanë rrjedhur zhvillimet 20 vjet më parë kur fillova aktivitetin tim. Toka në Polat, Divjakë, nga ku jam unë, është shumë pjellore dhe kam filluar me mbjelljen e perimeve në fusha si speca të kuq, brokoli dhe lulëlakër. Deri në vitin 2005 unë zgjerova aktivitetin, duke ndërtuar një serrë diellore. Rezultatet ishin të mira dhe gjatë viteve rrita sipërfaqen e serrës. Kjo ishte koha kur bëra njohjen time me FED invest dhe kredia e parë më ndihmoi të rritja sipërfaqen e serrës në 0.7ha.

Pas një kredie tjetër, duke punuar edhe më shumë, në vitin 2016, unë kisha 1.2ha sipërfaqe serrë.

Por, nuk ishte vetëm financimi që më ndihmoi të rritem. FED invest, gjithashtu, më ndihmoi të rritem si fermer dhe sipërmarrës. FED invest më dërgoi të ndiqja një trajnim me fermerë në Holandë për të fituar përvojë moderne në bujqësi.

Një kredi tjetër në vitin 2017 do të më ndihmonte në përmirësimin e aktivitetit tim. Hapi tjetër në biznesin tim ishte ngritja e një depo-grumbullimi. Ndërtova depon me qëllim mbledhjen e produkteve bujqësore të zonës ku banoj për t'i eksportuar në vendet e Evropës Lindore si Rumania, Serbia, Bullgaria, Mali i Zi, etj. Kredia tjetër në FED invest më lejoi investimin në një makineri paketimi dhe ambalazhimi për eksport. Aktualisht kam dhjetë punonjës dhe sipërmarrja ime po shkon mirë.



AGIM MITA

Prej 11 vitesh anëtar i FED invest, kam ndërtuar një agrobiznes të suksesshëm që më mundëson të mbështes familjen time, të zhvilloj aftësitë e mia si një fermer, sipërmarrës dhe t'i shërbej komunitetit. Pas shumë vitesh jetesë në Greqi, familja ime dhe unë u kthyem në Bubullimë në 2009 për të filluar një jetë të re.

Kur vendosa të merresha me bujqësi, u bëra anëtar i FED invest. Me kredinë time të parë, ndërtova një serrë perimesh prej 2 dynym. Aktiviteti u rrit gradualisht dhe në mënyrë të qëndrueshme dhe me të ardhurat e gjeneruara, shumë shpejt arrita të paguaj kredinë plotësisht. I nxitur nga ky sukses, unë aplikova për një kredi të dytë në 2010 dhe zgjerova aktivitetin e fermës. Ndërkohë që aktiviteti u rrit, besimi im gjithashtu. Prandaj vendosa të zgjerohem përsëri në 2013, falë një kredie të tretë me FED invest, ku zgjerova përsëri sipërfaqen e serrës me 1000 m².

Në prill të vitit 2016, një stuhi shkatërruese goditi rajonin e Lushnjës dhe dëmtoi shumë serra, përfshirë edhe plastmasin e serrës sime. Shumë fermerë u përballën me vështirësinë e humbjes së prodhimit dhe falimentimit. Në një kohë kur asnjë institucion tjetër nuk më ofroi mbështetje, FED invest qëndroi pranë meje dhe anëtarëve të tjerë për të vlerësuar nevojat financiare e për të financuar rimëkëmbjen e biznesit. Falë mbështetjes së tyre, unë arrita të riparoj dëmin në serrën time.

Në vitet në vijim, unë kam qenë në gjendje të zgjeroj serrën time në 6000m² dhe të njihem me teknikat e reja të në bujqësi dhe informacionin e tregut. Tani, unë mund të ndaj ekspertizën time për risitë e tregut dhe aplikimin e teknologjisë së domateve dhe kastravecëve hibride me fermerët e tjerë të zonës.

FOTO TË ANËTARËVE SIPËRMARRËS





Rr. Qemal Stafa, nr.70
Tiranë, Shqipëri
Tel/Fax: + 355 4226190/1
info@fedinvest.al
fedinvest.al